



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

URDHËR

Nr. 728 datë 30/04 2015

PËR

PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË MODERNIZIMIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, pikës 2, germa E, neni 13 të ligjit nr. 64/2014, datë 28.06.2014 "Për pushtetet e autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 08.03.2007 "Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik", i ndryshuar me vendimin nr. 1403, datë 27.10.2008, të Këshillit të Ministrave;

URDHËROJ:

1. Pika 2 e urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes, nr. 1327, datë 15.12.2008 "Për përbërjen dhe funksionimin e Bordit të Modernizimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshojë si vijon:

Zëvendësuesi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	Kryetar
Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	Zv.kryetar
Komandanti i Forcës Tokësore	Anëtar
Komandanti i Forcës Detare	Anëtar
Komandanti i Forcës Ajrore	Anëtar
Komandanti i Doktrinave dhe Stërvitjes	Anëtar
Komandanti i Komandës Mbështetëse	Anëtar
Drejtori i Drejtorisë së Zbulimit, J2, SHP	Anëtar
Drejtori i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes, J3/7, SHP	Anëtar
Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës, J4, SHP	Anëtar
Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes, J5/8, SHP	Anëtar
Drejtori i Drejtorisë së Ndërlidhjes, J6, SHP	Anëtar
Specialist nga Drejtoria e Legjislacionit, MM	Anëtar

2. Sekretar i Bordit të Modernizimit caktohet Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit të Forcës në Drejtorinë, J5/8, në Shtabin e Përgjithshëm.
3. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve të NATO-s dhe Modernizimit ose zëvendësi i tij, kur i janë deleguar kompetencat për ushtrimin e funksionit organik „merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Modernizimit, pa të drejtë vote.
4. Në rastet kur një anëtar i Bordit të Modernizimit mungon për arsye objektive, përfaqësimi në mbledhjen e bordit të bëhet nga zëvendësi i tij, kur i janë deleguar kompetencat për ushtrimin e funksionit organik.
5. Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1385, datë 29.08.2011 “Për përbërjen dhe funksionimin e Bordit të Modernizimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, revokohet.
6. Me këtë urdhër të njihen të gjitha Drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, si dhe Komandat e reparteve kryesore.
7. Ndjekin zbatimin e këtij urdhri Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

